



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-16334

PROCESVERBAL:

Dëgjim buxhetor:

Buxhetin për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026 me sektorin e bujqësisë

Data: 24.07.2023

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora 14:00

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar draft buxhetin për vitin 2024, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna,, organizoi dëgjim buxhetor me sektorin e bujqësisë.

Fillimisht takimin e hapi Drejtori për Bujqësi, Plltari dhe Zhvillim Rural Suhad Dullovi, i cili përmendi shifrat e buxhetit të ndara për bujqësi, e në veçanti për subvencione.

Rrustem Zenuni- Fermer- përgëzoi komunën për arritjet e deri tashme në sektorin e bujqësisë, ndërsa kërkoi ndryshim të formës së subvencioneve. Të gjithë ata që bënë pyetje dhe kërkesa morën përgjigje nga ana e drejtorit si dhe diskutuan në lidhje me temat e ngritura në debat.

Hamdi Deda- fermer- Rruga për Lybeten do të na ndihmonte dhe do të na lehtësonte punën neve si fermer. Andaj kërkoj që kjo rrugë sa më parë të rregullohet në bazë të mundësive të komunës që ka.

Kenan Berisha- kërkesë për rritje të subvencioneve me serra si dhe ndryshim të kriterëve për përfitimin e mekanizmave bujqësorë.

Për të gjitha pyetjet dhe kërkesat dha përgjigje drejtori Suhad Dullovi dhe stafi i drejtorisë, ndërsa u diskutua në lidhje me këto kërkesa dhe mundësitë e realizimit të tyre.



Procesmbajtësi
Fatlume Guri Selimi